

BULETINI INFORMATIV



Gjatë muajit maj 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar ushtrimin e kompetencave të tij rregullatore dhe vendimmarrëse në sektorin e energjisë, në përmbushje të misionit për garantimin e një tregu energjetik transparent, të qëndrueshëm dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në këtë përmbledhje mujore do të gjeni informacion mbi licencimet e reja të miratuara, publikimet dhe njoftimet e rëndësishme, të dhënat kryesore të tregut, çmimet e shitjes së energjisë elektrike, si dhe dokumentet dhe aktet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik. Buletini ju informon në mënyrë të qartë dhe periodike subjektet e licencuara, institucionet, konsumatorët dhe publikun e gjerë mbi zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e energjisë.

Për më shumë detaje, vendimet dhe dokumentet e plota mund t'i shfletoni në faqen tonë zyrtare: www.ere.gov.al

LICENCIME

Procedura të filluara gjatë muajit maj 2026

Gjatë muajit maj, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “PREMIUM GREEN ENERGY” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Po ashtu, Bordi i ERE-s, ka filluar procedurat edhe për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” shpk, “POWER ENERGY” shpk dhe “GreeNNat Solar Park Ballsh” shpk. Ky modifikim lidhet me shtimin e veprave ndihmëse/njësi të depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencave respektive, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centraleve përkatëse të këtyre shoqërive. Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjensia Kombëtare e Mjedisit si dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit .

Gjithashtu, për aplikimet e mësipërme, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve të mundshme para vendimmarrjes respektive të licencimit ose jo.

Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit maj

Gjatë muajit maj 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) zhvilloi 4 mbledhje vendimmarrëse, të njoftuara paraprakisht në përputhje me kërkesat e transparencës institucionale. Njoftimet për zhvillimin e mbledhjeve u publikuan

të paktën 24 orë përpara në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të ERE-së, duke u mundësuar të gjitha palëve të interesit ndjekjen e tyre në kohë reale përmes transmetimit online. Në kuadër të këtyre mbledhjeve, Bordi shqyrtoi dhe miratoi gjithsej 27 vendime, të cilat lidhen me ushtrimin e kompetencave rregullatore të ERE-së në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Vendimet e miratuara përfshijnë fillimin e procedurave të reja të licencimit, miratimin e licencave dhe autorizimeve, modifikimin e licencave ekzistuese, pezullimin ose zgjatjen e afateve procedurale, si dhe miratimin e çmimeve dhe tarifave të ndryshme të rregulluara. Në funksion të informimit të publikut dhe rritjes së transparencës, pas çdo mbledhjeje është publikuar një përmbledhje e vendimmarrjes së Bordit në kanalet zyrtare të komunikimit të institucionit. Ndërkohë, tekstet e plota të vendimeve janë të aksesueshme në faqen zyrtare të ERE-së, në seksionin “Vendime”, si dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

BULETINI INFORMATIV



Vendime licencimi

Vendime licencimi

Gjatë muajit maj 2026, Bordi i ERE-s ka vendosur të licencojë shoqëritë, si vijon:

-“PROSOL” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 01.03.2027.

-“ELENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë në Qarkun e Elbasanit, me afat vlefshmërie të licencës deri më 18.09.2052. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 13.01.2027.

-“PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

-“KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

-“SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Vendime modifikim licence

Bordi i ERE-s gjatë muajit maj, ka vendosur modifikimin e licencave të prodhimit të energjisë elektrike, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar, përkatësisht për:

- shoqërinë “SPV BLUE 1” shpk, për licencën e dhënë me vendimin e Bordit 116, datë 24.05.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq me kapacitet të instaluar 50 MW,b me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, i ndryshuar, duke shtuar veprat ndihmëse/objektet e depozitimit të energjisë elektrike, si komponent teknik i integruar funksionalisht në impiantin ekzistues prodhues, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

- “SPV BLUE 2” shpk për licencën e dhënë me vendimin e Bordit nr. 296 datë 30.12.2024; për prodhimin të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, duke shtuar veprat ndihmëse/objektet e depozitimit të energjisë elektrike, si komponent teknik i integruar funksionalisht në impiantin ekzistues prodhues, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Vendime të tjera

Gjatë muajit maj, në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit përkatës të licencimit, Bordi i ERE-s ka vendosur të ndryshojë vendim nr. 198, datë 15.08.2025 “Për licencimin e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimin nr. 238, datë 06.11.2024 “Për licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”; vendimin nr. 174, datë 29.08.2024 “licencimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimin nr. 91, datë 02.04.2026, “Për licencimin e shoqërisë “DION ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq, me kapacitet të instaluar 2 MW”, si dhe vendimin nr. 171, datë 31.07.2025, “Për licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq me kapacitet të instaluar 30 MW”, i ndryshuar. Ndryshimet në vendimet e sipërcituara lidhen me përditësimin e infomacionit dhe dokumentacionit në kuadër të plotësimit të kushteve të licensimit të këtyre subjekteve.

BULETINI INFORMATIV



REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021, si dhe me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ka vijuar me përditësimin e të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (Regjistri REMIT). Për vitin 2026, numri total i shoqërive të regjistruara në regjistër është 99. Ky regjistër gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen zyrtare të ERE-s: remit.ere.gov.al.

AUTORIZIME PËR GARANCI FINANCIARE

Gjatë këtij muajit maj 2026, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesat për marrje autorizimi si më poshtë vijon:

Transferim asetesh

Bordi i ERE-s, ka vendosur të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 342, datë 23.12.2025 “Mbi fillimin procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të asetëve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sha”, bazuar në njoftimin e bërë nga ana e shoqërisë dhe angazhimin e saj për të depozituar një aplikim të ri në vijim të ristrukturimit të kredive.

Për këtë vendim është njoftuar shoqëria, banka financuese dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ndryshim ortaku

Bordi i ERE-s ka vendosur të japë autorizimin shoqërisë “NRG Power” shpk për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e saj.


Për këtë vendim është njoftuar shoqëria

GARANCITË E ORIGINËS

Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë 2 (dy) kërkesa për krijimin e llogarive në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në kategoritë prodhues dhe tregtar i energjisë elektrike si dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralet fotovoltaik, për shoqëritë “Erseka Solar Park 1” shpk dhe “5GX ENERGY” shpk.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë.

BULETINI INFORMATIV



TREGU I ENERGJISË

Kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë gjatë muajit prill i është shtuar një central fotovoltaik i pozicionuar në zonën e Fierit, Njësia Administrative Topojë me kapacitet të instaluar prej 2 MW, i cila operohet nga shoqëria “DION Energji” sh.p.k., si dhe centrali hidrik HEC “Arçov” me vendndodhje në qarkun Elbasan me kapacitet të instaluar 1.28 MW, i cili operohet nga shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. Të dyja shoqëritë zotërojnë kontrata shitblerje energjie me “FTL” sh.a. me çmim të rregulluar.

Prodhimi neto i realizuar nga HEC-et e Kaskadës së Drinit për këtë muaj është 292,484 MWh ose rreth 16% më shumë energji elektrike e prodhuar se muaji prill i vitit të kaluar. Niveli i liqenit të Fierzës i cili është bazeni kryesor në kaskadën e lumit Drin në fillim muaji arriti kuotën prej 291.82 mmnd ndërsa fundi i muajit u mbyll në nivelin 294.85 mmnd. Sikurse evidentuar pergjatë këtij muaji kemi rritje të nivelit të ujit në liqenin e Fierzës prej rreth 3.03 metër. Prurjet mesatare mujore në këtë liqen rezultuan 226 m³/sek ndërsa rezerva energjitike për kaskadën e Drinit në fund të muajit prill ishte 1428.3 GWh.

Përgjatë këtij muaji shoqëria publike “KESH” sh.a. nuk ka pasur shkarkime pa prodhim energjie nga portat e HEC-eve në kaskadë si dhe nuk ka kryer procedura blerjeje energji elektrike në treg të parregulluar sipas detyrimit për shërbimin publik të vendosur në VKM 456/2022, e ndryshuar.

Prodhimi total neto vendas për muajin prill u përlogarit 758,207 MWh ose rreth 58% më shumë energji elektrike e prodhuar se periudha korresponduese e vitit të kaluar ku kontribuesit kryesorë kanë qenë centralet hidrike me 86% dhe centralet fotovoltaike me 14%.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për muajin prill rezultoi 116,931 MWh (dalje), si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 253,376 MWh dhe importit të realizuar në vlerën 136,444 GWh.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike për këtë muaj arrijnë në 12.88%, ndërsa ato të sistemit të transmetimit në vlerën 1.89 %.

Në të gjitha tregjet e ALPEX-it gjatë muajit prill u tregtuan gjithsej 193,692.29 MWh energji elektrike, ndërsa rrjedha ndërkufitare arriti në 58,123.17 MWh. Në Tregun e Ditës në Avancë u tregtua një volum total prej 190,103.16 MWh energji elektrike, me një çmim klerues mesatar prej 84.77 €/MWh ndërsa në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë u tregtua gjithsej 3,589.13 MWh me një çmim mesatar ditor klerues prej 90.60 €/MWh. Numri i Anëtarëve të Bursës ishte 45, të cilët morën pjesë në Tregun e Ditës në Avancë, ndërsa 32 prej tyre edhe në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë. Numri i Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit arriti në 6.

BULETINI INFORMATIV

VENDIME PËR ÇMIMET DHE TARIFAT

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e datës 13 maj 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, në vlerën 12.75 lekë/kWh për muajin prill 2026. Krahasuar me muajin mars 2026, kur çmimi i miratuar ishte 14.00 lekë/kWh, rezulton një ulje prej rreth 8.9%. Kjo rënie reflekton kryesisht uljen e kostos së blerjes së energjisë elektrike në tregun e lirë, e cila përbën komponentin kryesor të çmimit të furnizimit në kushtet e mundësisë së fundit.

Për muajin prill 2026, kostoja mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së rezultoi 9.01 lekë/kWh, kundrejt 10.23 lekë/kWh në muajin mars 2026, duke shënuar një ulje prej rreth 11.9%. Gjatë kësaj periudhe, sasia e energjisë së siguruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV arriti në 209.1 MWh, ose rreth 30% më shumë krahasuar me muajin paraardhës. Çmimi i furnizimit nga FMF për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV mbetet i pandryshuar në vlerën 18.26 lekë/kWh, sipas vendimmarrjes së Bordit të ERE-së të muajit shkurt 2026. Ky çmim ruan karakterin fikse, pasi energjia për këtë kategori klientësh sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi.

Në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, ERE vijon të miratojë dhe publikojë periodikisht çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, duke garantuar transparencë dhe informim të vazhdueshëm për pjesëmarrësit në treg dhe palët e interesuara.

Gjatë muajit maj 2026 është zhvilluar seanca dëgjimore teknike si më poshtë vijon:

- Seancë dëgjimore teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Në këtë seancë dëgjimore teknike u diskutua mbi dokumentacionin e përcjellë në kuadër të planit 5 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 2023-2027 nga shoqëria OSSH sh.a.

Gjithashtu në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 275, datë 13.12.2024 nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a, ku u konkludua se shoqëria FSHU sh.a ka përmbushur detyrat e lëna në pikën 2 të vendimit nr. 275, datë 13.12.2024 për sistemimin e faturave të muajit shtator 2024 duke korrigjuar dhe kompesuar diferencat rezultuese të muajit shtator 2024 në faturat e muajit dhjetor 2024.

TË TJERA MBI TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

U miratua “Vlerësimi i ERE-s për gatishmërinë e tregut të ditës në avancë në Shqipëri”, bazuar në metodologjinë e miratuar dhe ligjin nr. 24/2023. Vlerësimi tregon se tregu ALPEX nuk plotëson ende kriteret për përdorim si çmim referencë në mekanizmat CfD për burimet e rinovueshme, për shkak të likuiditetit dhe thellësisë së kufizuar, ndërkohë që evidentohen edhe disa tregues pozitivë të zhvillimit të tregut si disponueshmëria e vazhdueshme e çmimit referencë për 12 muaj, konkurrueshmëria e anës së shitjes dhe bid-ask spread në 97.5% të orëve. Vlerësimi do të përsëritet çdo 6 muaj, sipas metodologjisë së miratuar.

Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit prill është përditësuar informacioni në ëebin e ERE-s www.ere.gov.al dhe rrjetet sociale me [vendime](#), [njoftime të mbledhjeve](#), [njoftime mbi aplikime të reja për licencim](#) si dhe [çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2026](#).

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))